

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësie Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2 2 2 2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date	652 652 01,04,2022



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/**  
**Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija /**  
**Ministry of Education, Science, Technology and Innovation**

**Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary**

Në bazë të Ligjit nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dt.17 dhjetor 2021, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019) si dhe nevojës së dhënies së udhëzimeve Drejtorive Komunale të Arsimit për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore, u nxor ky:

## **UDHËZUES PËR ZËVENDËSIMIN DHE PAGESËN E MËSIMDHËNËSVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE**

### 1. Qëllimi i udhëzuesit

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) për marrjen e vendimit për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nga buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2022.

## **2. Vlerësimi i aftësisë për punë i mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore**

- 2.1. Vlerësimin e aftësisë për punë të mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore dhe shkallën e sëmundjes e bëjnë Institucionet Shëndetësore Publike (ISHP) përmes raporteve mjekësore.
- 2.2. Raportet mjekësore nga Institucionet Shëndetësore Publike, dorëzohen në Drejtoritë e Institucioneve Edukativo- Arsimore (IEA).
- 2.3. Drejtorët e IEA, raportet e pranuar nga ISHP, i dorëzojnë në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA).
- 2.4. DKA në bashkëpunim me drejtorin e IEA, i shqyrtojnë dhe verifikojnë raportet e ISHP dhe pajtohen për zëvendësimin dhe pagesën e mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore.
- 2.5. Vendimin për zëvendësim dhe pagesë të mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore, e nxjerr drejtori i DKA-së.
- 2.6. Zëvendësimi i mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore bëhet pas shfrytëzimit të pushimit të lejuar mjekësor .
- 2.7. Zëvendësimi i mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore bëhet deri në fund të një gjysmëvjetori.
- 2.8. Zëvendësimi mund të ndërpritet në rast të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të mësimitdhënësve, bazuar në dëshmitë mjekësore nga ISHP.

## **3. Mënyra e zëvendësimit**

- 3.1. Zëvendësimin e mësimitdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore e bëjnë DKA-të.
- 3.2. Zëvendësimi bëhet me mësimitdhënës të drejtimit përkatës duke:
  - 3.2.1. Angazhuar mësimitdhënës të punësuar në komunë që nuk e kanë normën e plotë;
  - 3.2.2. Angazhuar mësimitdhënës të punësuar në komunë që mund të marrin orë shtesë/mbinormë;
  - 3.2.3. Angazhuar mësimitdhënës të rinj nga lista e pritjes;
  - 3.2.4. Shpallur konkurs.

#### 4. Forma e pagesës

- 4.1. Mbështetur në dëshmitë mjekësore dhe vendimin e DKA-së, mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore, paguhen 100% të pagës bazë (baza e kontratës që ka të lidhur me institucionin përkatës).
- 4.2. Në pagë përfshihet edhe shtesa për përvojën e punës, kurse shtesa e kualifikimit nuk përfshihet.

Me dt. 01/04/ 2022

\_\_\_\_\_  
Fadile Dyla, zv. sekretare e përgjithshme MASHTI



